

VENDIM
Nr. 510, datë 30.8.2023

**PËR PËRCAKTIMIN E MASËS DITORE TË PËRFITIMIT DHE PROCEDURËS
SË KOMPENSIMIT PËR STREHIM PËR PUNONJËSIT E GARDËS SË
REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË**

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës dhe të pikës 2, të nenit 51, të ligjit nr. 33/2021, “Për Gardën e Republikës së Shqipërisë”, me propozimin e ministrit të Brendshëm, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përcaktimin e masës ditore të përfitimit dhe procedurës së kompensimit për strehim për punonjësit e nivelit të mesëm e të lartë të Gardës së Republikës, të cilët emërohen ose transferohen në detyrë jashtë vendbanimit të përhershëm dhe nuk u sigurohet nga Garda mjedisi për akomodim.

2. Kur punonjësi nuk ka në ngarkim persona të tjerë familjarë, me të cilët zhvendoset jashtë vendbanimit të përhershëm, i paguhet qiraja e banesës për sipërfaqe banimi deri në 30 m² neto. Për çdo person familjar shtesë, sipërfaqja neto shtohet me 10 m².

3. Numri i personave, pjesëtarë të familjes, në ngarkim të punonjësit të Gardës së Republikës vërtetohet nëpërmjet certifikatës familjare, në momentin e emërimit ose transferimit.

4. Garda e Republikës bën kompensimin e qirasë së banesës së punonjësit, përkundrejt paraqitjes së kontratës së noterizuar të qirasë, sipas legjislacionit përkatës në fuqi. Në kontratë përcaktohet qartë adresa ku ndodhet ndërtesa, sipërfaqja në metër katror dhe vlera mujore e qirasë së objektit.

5. Masa ditore e përfitimit të kompensimit për strehim do të jetë sa 1/30 e vlerës minimale të qirasë mujore, sipas përcaktimeve në vendimin nr. 469, datë 3.6.2015, të Këshillit të Ministrave, “Për përcaktimin e vlerës minimale të çmimit të referencave të qirave të ndërtesave për qëllime tatimore”.

6. Punonjësi i Gardës së Republikës, që përfiton kompensim për qira banese, paraqet pranë sektorit të burimeve njerëzore dokumentet e mëposhtme:

- a) kërkesën me shkrim për kompensimin e qirasë së banesës;
- b) fotokopjen e kartës së identitetit;
- c) certifikatën personale dhe certifikatën familjare;
- ç) kontratën e noterizuar të qirasë së banesës ku është transferuar;
- d) vërtetimin nga Drejtoria Vendore e ASHK-së se ai ose pjesëtarët e familjes, që ka në certifikatën e gjendjes familjare, nuk kanë banesë apo nuk kanë aplikuar për legalizim banese, në juridiksionin ku është emëruar ose transferuar.

7. Verifikimi i dokumentacionit të paraqitur nga punonjësi dhe përllogaritja e shumës së përfitimit të kompensimit të qirasë së banesës bëhet nga komisioni, me këtë përbërje:

- a) drejtori i Drejtorisë së Shërbimeve Mbështetëse;
- b) shefi i sektorit të burimeve njerëzore;
- c) shefi i sektorit të buxhet-financës;
- ç) specialisti i infrastrukturës;
- d) specialisti jurist.

8. Sektori i burimeve njerëzore njofton komisionin për paraqitjen e dokumentacionit nga punonjësi. Komisioni, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga paraqitja e dokumentacionit, bën vlerësimin e tij dhe në rast të pranimit të kërkesës bën përllogaritjen e shumës së përfitimit të kompensimit të qirasë së banesës. Komisioni merr vendim me shumicë, në prani të të gjithë anëtarëve të tij. Në bazë të vendimit të komisionit, drejtori i përgjithshëm nxjerr urdhrin për kompensimin e qirasë së banesës për punonjësin.

9. Ngarkohen Ministria e Brendshme dhe Garda e Republikës për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi pas botimit në Fletoren Zyrtare.

KRYEMINISTËR
Edi Rama